


Nr. 5032/1 Prot

Dt. 11.10.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODER



Nr. 633/2 Prot.

Shkodër, më 7.10.2022

**Lënda:** Mbi Vendimin nr. 62, datë 23.09.2022 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS



Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 9, pika 1.2, shkronja "a", neni 18, neni 27, pika 5, neni 54, shkronja "e/1", neni 55, pika 3, neni 64, shkronja "c", të ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet", neni 25/1/c, ligj nr.43/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"<sup>1</sup> neni 4, 5, të VKM nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive", të ndryshuar, pika 49, shtojca 47 të VKM nr. 559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", të Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr. 1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kulloror publik", shqyrtoi **VKB nr. 62, datë 23.09.2022 "Për dhënie në përdorim të sipërfaqes pyjore prej 3.9 ha me afat 10 vjeçar<sup>2</sup> për "Park fotovoltaik" (stacionet dhe objektet përkatëse), në ekonominë pyjore Drin Gjadër Kir, ngastra nr.4"**.

Pas shqyrtimit, Prefekti vëren se është kompetencë e Këshillit Bashkiak dhënie në përdorim e pronave të Bashkisë në zbatim të nenit 54, shkronja "e/1" të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, duke zbatuar procedurat e konkurrimit publik, për të cilat ju lejohet procedimi.

Në vëmendje për zbatim kriteret e nenit 66, paragrafi i dytë si dhe neni 67, të ligjit nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar, kjo sipas shkresës së strukturës së specializuar Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore me nr. 1108/1, datë 23.10.2020.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKT

Majlinda ANGOINI



<sup>1</sup> Prioritet, objektiv i Qeverisë Shqiptare

<sup>2</sup> Elementi i rinovimit është pjesë e kontratës gjatë zbatimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr. 62 datë 23.09.2022

**“Për dhënien në përdorim të sipërfaqes pyjore prej 3.9 ha me afat 10 vjeçar “për park fotovoltaik”, (aerogjeneratore, stacionet, objektet përkatëse, etj) në ekonominë pyjore Drin Gjader Kire.”**

Në mbështetje të nenit 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “e”, neni 18 pika 2 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 25 pika 1 e ligjit nr. 57/2020 datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, Udhëzimi i Ministrisë së Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor/ kullosor publik me shumicë të cilsëuar votash:

**V E N D O S I**

1. Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes prej 3.9 ha “për park fotovoltaik”, (aerogjeneratore, stacionet, objektet përkatëse etj) në ngastrën nr.4 të ekonomisë pyjore Drin Gjader Kire.
2. Afati i dhënies me qera të jetë 10 (dhjetë) vjeçar me të drejtë rinovimi.
3. Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM-së nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”, Shtojca 1, pikat pika 8/5.
4. Efektet: Jep impaktë pozitive tek komuniteti, sigurohen të ardhura të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.
5. Ngarkohen Drejtoria e Pyjeve, dhe Turizmit dhe mbrojtjes së Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

**K R Y E T A R  
MARK BISHA**

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
**ARDIAN ÇELEPIJA**

Miratuar me 23 vota

Vota Pro 23

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 28.09.2022